



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 53.1, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenet 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, 47 paragrafi 1 dhe nenin 49 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Sipas Shkresës së Ministrisë së Pushtetit Lokal nr.020-201/14 të datës 29.03.2022, për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, pas rishqyrtimit të aktit, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2022, mori këtë,

VENDIM

PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Themelohet Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

- 1- **Qëndresë Hajrizi**, anëtare nga radhët Kuvendit të Komunës-LVV
- 2- **Haki Rudari**, anëtar nga radhët Kuvendit të Komunës-LVV
- 3- **Demokrat Hodolli**, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-LDK
- 4- **Arbnor Fazliu**, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-AAK
- 5- **Albina Avdiu**, anëtare nga radhët e Komunitetit Ashkali
- 6- **Xhafer Ademi**, anëtar nga radhët e Komunitetit Ashkali
- 7- **Shkurte Sejdiu**, anëtare nga radhët e Komunitetit Ashkali
- 8- **Muhamet Sadiku**, anëtar nga radhët e Komunitetit Rom
- 9- **Sevdije Mustafa**, anëtare nga radhët e Komunitetit Egjiptian

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlidhet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual, bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komitetit për Komunitete, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, rregulloren e punës së Komiteteve, dhe dispozitat tjera përkatëse në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021

Nr.prot. 01-020/02-0030731/22
Podujevë, datë, 29 prill 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha